# DËSHMI ARKIVI

**A-447453**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Serwer: Mbajtja e ish-krerëve të UÇK-së në paraburgim për 5 vjet, e papranueshme |
| ADRESA | `https://piranjat.al/kosova/serwer-mbajtja-e-ish-krereve-te-uk-se-ne-paraburgim-per-5-vjet-e-papranue-i104334` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 21:33:08 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 21:27:57 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `05425f53ac13841ba7e9df5decbfa1628a30929d57d3ab63c788331b9a12cf0d` |
| TEKSTI | `9b83ef66e5acc7ad3f8820ebd393e7cbd92145b4bb6d5e3ae8d437c4cb7e4c3b` |
| PAMJA | `3d16ecdcb519665829aff62b02adbc52ec09adc7ab7f8d9ed742a9d83be0e03f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `65b1472803c241937806387d09b8fe1f736c89d698f0c5df47902c8d04c144d3` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aa0d8cfc8113ea79b7663cf26341788a60de665698217179c4b01fa71930ced4` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/65b1472803c241937806387d09b8fe1f736c89d698f0c5df47902c8d04c144d3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVA

# Serwer: Mbajtja e ish-krerëve të UÇK-së në paraburgim për 5 vjet, e papranueshme

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 23:27



Ish-diplomati amerikan Daniel Serwer ka kritikuar ashpër punën e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, duke thënë se është penduar që e ka mbështetur themelimin e kësaj gjykate.

Serwer tha se fillimisht e kishte përkrahur Gjykatën Speciale me bindjen se ajo do të hetonte pretendimet për trafikim të organeve njerëzore, të ngritura në raportin e ish-senatorit zviceran Dick Marty.

Ai tha se, sipas tij, këto pretendime nuk janë mbështetur me prova. “Fakti i çështjes është që nuk janë gjetur asnjë lloj dëshmie apo fakti për të vërtetuar pretendimet për trafikim organesh”, deklaroi Serwer.

Sipas tij, problemi qëndron në faktin se gjykata, pasi nuk gjeti prova për këto pretendime, e zgjeroi mandatin e saj edhe në veprime të tjera të UÇK-së.

“Për mua, nëse krijon një gjykatë për të hetuar një pretendim, dy pretendime të caktuara, sigurisht që duhet të hetohen ato pretendime të caktuara. Kjo është bërë, nuk janë gjetur faktet, por pastaj kanë dalë diku tjetër. Për mua kjo nuk është legjitime”, tha ai.

Serwer kritikoi edhe mënyrën se si, sipas tij, është trajtuar struktura komanduese e UÇK-së. Ai tha se UÇK-ja nuk ka pasur një zinxhir komandues të centralizuar, të ngjashëm me atë të forcave serbe.

“UÇK-ja sigurisht që ka qenë grup i paligjshëm në kuptimin e pushtetit të Serbisë, por kjo nuk është gjë për t’u marrë një tribunal ndërkombëtar”, u shpreh Serwer për rtk.

Ai tha se Gjykata Speciale, sipas vlerësimit të tij, është mbështetur shumë në informacione të siguruara nga Serbia, të cilat mund të kenë qenë të sakta ose të pasakta.

Serwer foli edhe për mundësinë e ndikimit politik në themelimin dhe funksionimin e gjykatës. Ai tha se është e vështirë të përcaktohet nëse ka pasur një qëllim politik nga ana amerikane, por theksoi se procesi ka pasur ndikim të madh politik në Kosovë.

Sipas tij, mbajtja e ish-krerëve të UÇK-së në paraburgim për më shumë se pesë vjet pa një verdikt përfundimtar është e papranueshme.

“Mbajtja në burg për pesë vjet me radhë pa dënim, pa verdikt gjyqësor, thjesht është e papranueshme”, tha Serwer.

“Sigurisht që s’kam si ta di, por sinqerisht shpresoj që të mos, çregullojë edhe më tutje gjendjen në Ballkan. Dhe besoj që ka potencial për të ndodhur kjo, sidomos kur e shohim Serbinë që bën atë nderimin për Mlladiçin dhe është gjë normale që viktimat e Mlladiçit dhe pastaj të Millosheviçit të reagojnë në mënyrë të kundërt, ose në drejtimin e kundërt. Është një bombë me sahat në njëfarë mënyre dhe nuk do të doja që kjo të ndikojë negativisht në perspektivën e Kosovës drejt anëtarësimit në NATO e pastaj edhe në BE”, tha tutje ai.

## Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 15 Shtator22:25

Vendoset ora e fundit e pritjes në Hagë, qindra shqiptarë sonte nën qiell të hapur

Pak metra larg objektit të Gjykatës Speciale, në vendin e quajtur Malieveld, është vendosur ora e pritjes në Hagë, në pr...

KOSOVA 15 Shtator21:40

**Përlotet Leonora Jakupi: E dhimbshme të mendosh se mund të dënohen liderët që sollën pavarësinë**

Në prag të 16 shtatorit, ditës kur pritet vendimi në Hagë për ish-krerët e UÇK-së, “Ftesë në 5&rd...

KOSOVA 15 Shtator21:21

**Sytë nga Haga, nesër shpallet vendimi për ish-krerët e UÇK-së**

Pas më shumë se katër vitesh proces gjyqësor në Hagë, nesër, më 16 shtator, pritet të shpallet aktgjykimi i shkall&...

KOSOVA 15 Shtator20:43

**Kurti për herë të katërt kryeministër/ Rama i dërgon letër: Mirë se të vish në Tiranë**

Kryeministri Edi Rama ka uruar Albin Kurtin për zgjedhjen për herë të katërt kryeministër i Kosovës, duke u zotuar për...

KOSOVA 15 Shtator20:34

**'Sonte nuk do të fle', aktivistja nga Vushtria pret lirimin e krerëve të UÇK-së: Uroj që nesër të festojë e gjithë Kosova**

Teksa kanë mbetur vetëm pak orë nga shpallja e vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë për Hashim Thaçin, Kadri Ves...

KOSOVA 15 Shtator20:25

**"UÇK-ja ka bërë luftë të pastër"/ Djali i Jakup Krasniqit tregon mesazhin që ia dha i ati, ja çfarë i tha**

Kur kanë mbetur më pak se 15 orë deri në shpalljen e vendimit të shkallës së parë të Gjykatës Speciale pë...

KOSOVA 15 Shtator20:16

**VIDEO/ Pak orë para vendimit për ish-krerët e UÇK-së, në Prishtinë ndizet “Flakët e Lirisë”**

Pak orë para shpalljes së aktgjykimit në Hagë për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në Prish...

KOSOVA 15 Shtator20:15

**Nesër vendimi për ish-krerët e UÇK-së, qindra shqiptarë me flamuj kuq e zi mblidhen në Hagë**

Qindra shqiptarë janë mbledhur para objektit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, në prag të shpall...

KOSOVA 15 Shtator19:56

**Shtohet siguria në Hagë para vendimit për ish-krerët e UÇK-së, policia largon shqiptarët nga Gjykata Speciale**

Policia holandeze ka shtuar masat e sigurisë përpara ndërtesës së Gjykatës Speciale në Hagë, vetëm pak orë par...

KOSOVA 15 Shtator19:26

**Kongresmeni amerikan paralajmëron Hagën: Paragjykimet politike të mos ndikojnë në vendimin për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-së**

Kongresmeni amerikan Keith Self ka reaguar lidhur me vendimin që pritet të merret nga Gjykata Speciale në Hagë për ish-krerët e U&...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 15 Shtator

**Sulmohet Arabia Saudite, bombardohet me raketa ...**

Huthët e Jemenit, të mbështetur nga Irani, kanë nisur një valë të re sulmesh ndaj Arabisë Saudite, ndërsa paralel...

AKTUALITET 15 Shtator

**Rrëfehet 34-vjeçarja: Daja i Zegjine Caushit më...**

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak ditë më parë në Roskovec, ku Bledar Bakaj shkoi në shtëpinë e ish-bashk&e...

AKTUALITET 15 Shtator

**Gjykata e Lartë merr vendimin për kreun e Bashk...**

Gjykata e Lartë shqyrtoi sot rigjykimin e çështjes që lidhet me masën e sigurisë ndaj kryebashkiakut të Tiranës, Eri...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

**Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik**

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

## video



## Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**




**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**






**PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.